




# MASA URGJENTE PER TE GJITHE TERRITORIN KOMBETAR

Ne fuqë nga 10 mars deri më 3 prill 2020



- 1** Shmangni çdo lëvizje përveçse për:
  - nevoja pune të provuar
  - situata nevoje
  - arsye shëndeti
  - kthimi në shtëpinë tuaj ose në vendbanimin tuaj
- 2** Me **simptoma të infeksionit të frymëmarrjes dhe temperature më shumë se 37.5°C**, qëndroni në shtëpi dhe kontaktoni mjekun e familjes.
- 3** **Ndalim absolut** i lëvizshmërisë për personat në karantinë ose te rezultuar pozitiv ndaj virusit.
- 4** Ndalim i çdo **forme grumbullimi të personave** në vendet publike ose të hapur publikut.
- 5** **Aktivitetet e restoranteve dhe lokaleve bar** lejohen nga ora 6 deri në orën 18. Menaxheri duhet t'u garantojë klientëve një distancë të paktën një metër ndërmjet personave.
- 6** **Aktivitetet e tjera** tregtare lejohen me kusht që administruesi të garantojë ndarjen të paktën një metër. Mbyllja në ditët e parapushimit dhe të festave të strukturave të shitjeve të mesme dhe të mëdha dhe të dyqaneve brenda qendrave tregtare dhe tregjeve. Mbeten hapur farmacitë, parafarmacitë dhe pikat e shitjeve ushqimore me rregull të një distance sigurie prej të paktën një metër.
- 7** Pezullimi i aktiviteteve të **palestrave, qendrave sportive, pishinave, qendrave të notit, qendrave të mireqenies ose termale, qendrave kulturore, sociale ose argëtimi**. Mbyllja e strukturave për ski.
- 8** Pezullimi i manifestimeve të organizuara dhe **shfaqjeve kulturore, rikreative, sportive, fetare dhe të panairave** në vende publike ose private, edhe nëse mbahen në vende të mbyllura por të hapura për publikun.
- 9** Mbyllja e **muzeve, instituteve dhe vendeve të kulturës**. Pezullimi i aktiviteteve në **kinema, teater, pub, shkolla baleti, sallë lojrash, sallë bastesh dhe salla bingo, disko** dhe lokale të ngjashme.

- 10** Pezullimi i **shërbimeve edukative për fëmijë** dhe të aktiviteteve arsimor neper **shkollat** e të gjitha vendeve dhe shkollëve. I lejuar në çdo rast trajnimi formues në **distancë**.
- 11** Pezullimi i ceremonive civile dhe fetare, përfshirë dhe funeralet. Hapja e **vendeve të besimit** kushtëzohet nga masa organizative të tilla që lejojnë distancimin e personave jo më pak se një metër.
- 12** Pezullimi i **shfaqjeve sportive dhe garave** të të gjitha llojeve dhe disiplinave në vende publike ose private, përveç atyre që organizohen nga organizata sportive ndërkombëtare pa praninë e publikut. **Strukturat sportive** mund të përdoren me dyer të mbyllura për sesione stërvitore të atletëve, në funksion të pjesëmarrjes së tyre në lojërat olimpike ose gara kombëtare dhe ndërkombëtare.
- 13** Pezullimi i **procedurave të konkurseve** publike dhe private, përveç personelit të kujdesit shëndetësor. Jane të lejuara procedurat që parashikojnë vlerësimin e kandidatëve eskuzivisht në baza kurrikulare ose në menyre elektronike.



[ancitoscana.it/coronavirus](http://ancitoscana.it/coronavirus)



[SALUTE.GOV.IT/NUOVOCORONAVIRUS](http://SALUTE.GOV.IT/NUOVOCORONAVIRUS)

